



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SEKRETARIA

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ .03.2020

NJOFTIM

**Për mbledhjen Nr. 13, date 26.03.2020 ora 13:30
të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; te ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë.16.07.2016 si dhe (iv) nenit 5 te Aktit Normativ nr. 3 dt. 15.03.2020 te Keshillit te Ministrave “Per Marrjen e Masave te vecanta Administrative gjate Kohezgjatjes se periudhes se infeksionit Covid -19”, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 26.03.2020, ora 13:30** do të zhvillohet mbledhja nr. 13 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

- 1- Për disa ndryshime të përkohëshme në procedurat e licensimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit covid-19-s dhe shpalljes së gjëndjes së fatkeqesisë natyrore në vendin tonë.
- 2- Mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k, me nr. 438, seria T19, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 38, datë 07.03.2019
- 3- Mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së furnizimit me energji elektrike të shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., me nr. 439, seria F19, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 39, datë 07.03.2019
- 4- Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 290, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 72, datë 13.05.2015
- 5- Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 291, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 73, datë 13.05.2015
- 6- Mbi shfuqizimin e pjesshëm të pikës 2, të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 142, datë 24.09.2019, për licencimin e shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe nr. 141, datë 24.09.2019 mbi licencimin e shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

7- Mbi shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 228, datë 26.10.2018, për licencimin e shoqërisë “Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Osoje” me kapacitet të instaluar 1952 kw në zonën e Moglicës –Korçë (lumi Osojë)

8- Mbi shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ere-s nr. 72, datë 10.05.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia administrative Topojë, Bashkia Fier”

9- Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a, për barrësim të asetëve të luajtshme (makineri dhe pajisje) në favor të “OTP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it “Dardha 1”

10- Informacion në lidhje me kërkesën e subjektit “Seman2Sun” sh.p.k., për aprovim në parim për transferimin e aksionerëve në përputhje me licencën nr. 409, seria P18K, sipas vendimit nr. 114, datë 14.05.2018, të bordit të ERE-s

Ne zbatim të pikës 1 të Urdherit të kryetarit të ERE-s nr. 53 date 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave degjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”, mbledhja nuk do të jete e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI